



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 15, datë 07.06.2016

PËR

DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 1, DATË 30.07.2015 “PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE PROCEDURAVE QË DO TË NDIQEN NGA AUTORITETET E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT PËR SHQYRTIMIN E KËRKESAVE PËR LEJE NDËRTIMI DERI NË MIRATIMIN E PLANEVE TË PËRGJITHSHME VENDORE”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, dhe Vendimit Nr. 1097, datë 28.12.2015 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozimin e Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Agjencisë së Zhvillimit të Territorit, Këshilli Kombëtar i Territorit

VENDOSI:

1. Në Vendimin Nr. 1, datë 30.07.2015 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave që do të ndiqen nga Autoritetet e Zhvillimit të Territorit për shqyrtimin e kërkesave për Leje Ndërtimi deri në miratimin e Planeve të Përgjithshme Vendore”, i ndryshuar, bëhen ndryshimet si vijon:
 - a) Në pikën 2, gërma “ë”, zëvendësohet me fjalinë si më poshtë:
“banesë njëfamiljare, kërkuar nga pronari i truallit, duke respektuar kushtet urbane sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar;”
 - b) Në pikën 2, gërma “f” zëvendësohet me fjalinë si më poshtë:
“shtesa në objektet e të gjitha rasteve përjashtimore sipas gërmave nga a) në f) të pikës 2, duke respektuar kushtet urbane sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



ZËVENDËS KRYETAR I KKT

EGLANTINA GJERMENI

MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN



SEKRETAR I KKT

LEDIA TOTA



DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT